



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Politikë dhe financa
Nr.01-060/01-4004/25 datë:18.02.2025



Npi – 01/64 datë: 21.02.2025

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008); Si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/155 datë: 27.04.2023, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 21.02.2025 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË -II- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

E mbajtur më datën: 21.02.2025 (e premte) në ora 10:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, Anëtarët e Komitetit: z.Përparim Ramusa, z.Lumni Amrush, znj.Adelina Beqaj, znj.Saniye Sadiki, znj.Zejnije Velu dhe z.Kadri Emini. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje ka marrë pjesë edhe: Drejtorët – z.Grejtalb Emini, DPUKGJ, znj.Mimoza Salihu-Qeriqi, DSHMS, z.Gojart Bajrami, DBPZHR, Asistentja e Kryesuesit, znj.Gentiana Mehmeti, Zyrtarët për Informim znj.Vlora Hyseni, dhe Albion Shabani. Mbledhjen e hapi, Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 24.01.2025,
2. Draft-Plani Ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt, (Pas diskutimit publik)
3. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësi tjera FN&FT për Janar-Dhjetor 2024
4. Propozim-Vendim për Subvencionimin e Nënave Lehona të Komunës së Shtimes për ç'do fëmijë të lindur,
5. Propozim-Vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm objektin afaristo-banesor përballë Komunës me komplet njësitë e sajë, dhe me ngastrën kadastrale Nr.P-01667-1, Z.K-Shtime,
6. Propozim-Vendim për anulimin e Vendimit Npi-01/346 dt. 31.10.2024 për themelimin e vendgjuetisë të përbashkët në teritorin e komunës së Shtimes.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Kadri Emini: Përshëndetje. Te Komisioni për emërtimin e rrugëve, anëtarë i të cilit jamë edhe unë, po propozoj që me futë si pike shtesë në këtë mbledhje edhe zëvendësimin tim me një anëtarë tjetër të Komisionit, për arsye se vërtetë jamë i ngarkuar dhe i nxanun shumë me punë dhe nuk po mundem me dhënë kontributin tim aty.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: E diskutojmë në mbledhjen e Kuvendit këtë propozim.

z.Përparim Ramusa: Përshëndetje. I uroj qytetarët tone për shpalljen nga Presidentja e Kosovës, Dëshmorin e komunës tonë Ruzhdi Salihaj (Hero i Kosovës). Pajtohem me pikat e rendit të ditës, ndërsa për propozimin e Kadriut diskutojmë në mbledhjen e Kuvendit.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 24.01.2025

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht miratoi Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 24.01.2025.**

Pika 2

Draft-Plani Ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt, (Pas diskutimit publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Para se të hapi diskutimin për këtë pike, fjalën ja jap drejtorit Bardhyl Rushitit për prezantimin e kësaj pike.

z.Bardhyl Rushiti, drejtor i DSHP: Përshëndetje. Bazuar në vendimin e Kuvendit, ne e kemi nxjerrë në diskutim publik, Draft-Planin Ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt. Diskutimin me qytetarë e kemi mbajtur më datën 11.02.2025 në ora 14:00h në sallën e Kuvendit. Propozime konkrete nga qytetarrët nuk kishte përveç diskutimeve të cilat qëllimin kryesor e kishin Implementimin e këtijë plani, me qëllim që ta kemi një ambient më të pastër. Spas këtijë mund ta quaj master plani për menaxhimin e integruar të mbeturinave ne si Komunë e shtimes bëjmë pjesë në rajonin e anamoravës Gjilan-Ferizaj. Deponia që planifikohet të ndërtohet sipas këtijë Plani do të jetë diku në mes të Gjilanit dhe Ferizajt. Meqenëse materialin e keni marrë me kohë dhe po besoj e keni lexuar, si dhe duke marrë parasysh mundësinë e diskutimit publik, unë nuk do ta zgjati shumë diskutimin tim, edhe pse ka shumë qka të diskutohet, sepse është një material vërtetë shumë voluminoz ku pjesa e parë është Plani Ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave, dhe pjesa e dytë është, Vlerësimi strategjik i planit ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave. Nëse keni ndonjë pyetje do të përpiqem që të përgjigjem. Ju ftoj që ta miratoni këtë Plan.

z.Kadri Emini: Përshëndetje. Ne si grup parlamentar jemi “Për” mirëpo në mbledhjen e Kuvendit do ti paraqesim disa propozime tona.

z.Lumni Amrushi: Përshëndetje. Unë desha ta bëj një pyetje lidhur me këtë Plan, se a ka diçka të veçantë, specifike ose të rëndësishme për komunën tonë, nëse ka atëher na thuaj? Sepse si plan ishte mjaft voluminoz.

z.Bardhyl Rushiti, drejtor i DSHP: Flm. Jo, nuk ka diçka të veçantë është thuaj se i njëjtë për të gjitha komunat e këtijë rajoni. Pra siç e thash ne si komunë i takojmë rajonit të anamoravës.

z.Përparim Ramusa: Unë e përkrahu secilën iniciativë e cila ka të bëjë me menagjimin e mbeturinave, kështu që ne gjithsesi jemi “Pro” dhe do ta përkrahim.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, me 6 vota “Për” me 1 votë “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim” vendosi t’i Rekomandon Kuvendit, MIRATIMIN e Planit Ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt (duke përfshi edhe Komunën e Shtimes).**

Pika 3

Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësi tjera FN&FT për Janar-Dhjetor 2024

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha drejtorit Bardhyl Rushitit.

z.Bardhyl Rushiti, drejtor i DSHP: Këtë raport e ka bërë Komisioni për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësi tjera gjatë vitit 2024. Sivjet për herën e parë po kërkohet që ky raport me kalu dhe me u miratu edhe në Kuvendet Komunale. E pas miratimit me vendim të Kuvendit me shku për pagesë në nivelin qendror. Meqenëse materialin e keni marrë me kohë unë

nuk do ta lexoj, sepse po besoj se të gjithë e keni pa dhe e keni lexuar. Nëse ka ndonjë pyetje unë këtu jam për tu përgjigjur. Ju ftoj që ta miratoni.

znj. Adelina Beqaj: Përshëndetje. Unë e kamë ngritë këtë qështje edhe më përpara. Kam një pyetje, cilat janë informatat që mundemi me i marrë tani për këtë çështje, sepse ka disa qytetarë që nuk janë paguar?

z. Bardhyl Rushiti, drejtor i DSHP: Ate që duhet ta dime është se neve fillimisht na nevojitet që ta miratojmë në Kuvend për ta dërguar në Ministri, e sigurisht që edhe në nivelin qendror ka një Komision që i vlerësojnë këto kërkesa. Pra pagesën nuk e bëjmë ne por e bën niveli qendror, dhe mendoj se mund të ketë raste që edhe nuk paguhen.

z. Kadri Emini: U tha se 14 kërkesa janë refuzuar nga Komisioni, ne duam ta dimë se për far arsye janë refuzuar dhe kush janë ata që janë refuzuar, sepse Kuvendi duhet ta dijë këtë?

z. Bardhyl Rushiti, drejtor i DSHP: Listën e emrave tani këtu me veti nuk e kamë por unë mund tua sjelli listen në Kuvend.

z. Përparim Ramusa: Meqenëse i kemi 14 kërkesa të refuzuara, deri sa nuk e kemi listën e këtyre në Kuvend unë do të "Abstenoj".

Kryesuesi, z. Adnan Ademi: Kërkojmë nga drejtori që në seancën e Kuvendit më 24.02.2025 të na i sjellë listen e palëve të refuzuara nga Komisioni.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, MIRATIMIN e Raportit Komisionit për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësive tjera (FN&FT) për periudhën Janar-Dhjetor 2024. Me kërkesën që në Kuvend drejtori ti sjell arsyetimet për 14 kërkesat e refuzuara nga Komisioni.**

Pika 4

Propozim-Vendim për Subvencionimin e Nënave Lehona të Komunës së Shtimes për çdo fëmijë të lindur

Kryesuesi, z. Adnan Ademi: Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha drejtoreshës Mimoza Salihu. **znj. Mimoza Salihu-Qeriqi, drejtoresh e DSHMS:** Këtë propozim-vendim e kemi diskutuar edhe miratuar në mbledhjen e kaluar të KPF-së, mirëpo Kuvendi e largoi nga rendi i ditës. Pra te ky propozim-vendim nuk kemi asnjë ndryshim tjetër përveq se kërkesën që mos të përsëritet nevoja që për ç' do vit me qitë për aprovim në Kuvend, kështu që ne po kërkojmë vetëm që viti mos të përmendet në vendim, por të vazhdon deri sa ka buxhet të miratuar për këtë qëllim. Përndryshe si propozim i yni nuk ka asnjë ndryshim tjetër. Nëse ka ndonjë pyetje do ti përgjigjem. Ju ftoj që ta miratoni këtë ndryshim.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Vendimit për ndarjen e subvencioneve për nënat Lehona për ç' do fëmijë të lindur, si vijon:**

1. Fëmija i I-rë do të subvencionohet me 100 €;
2. Fëmija i II-të do të subvencionohet me 150 €;
3. Fëmija i III-të e tutje do të subvencionohen me nga 200 €;
4. Fëmijët binjakë do të subvencionohen me 500 €;
5. Fëmijët trinjakë do të subvencionohen me 1000 €;
6. Shumës prej 1000 € (për trinjakë) do t'i shtohen edhe nga 500 € për çdo fëmijë të lindur njëkohësisht më shumë se trinjakë.

Pika 5

Propozim-Vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm objektin afaristo-banesor përballë Komunës me komplet njësitë e sajë, dhe me ngastrën kadastrale Nr.P-01667-1, Z.K-Shtime

Kryesuesi, z. Adnan Ademi: Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha drejtorit Grejtalb Emini.

z. Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ: Përshëndetje. Ky është një ndër vendimet më të rëndësishme që do ta marrim sepse po bëhet fjalë për objektin para Komune, i cili edhe mënyra se qysh është ndërtuar nën masa të dhunshme serbe të atëhershme, por edhe sipas gjendjes mjerruese që është tani, por ka edhe të meta të shumta teknike e që rrjedhimisht edhe paraqet rrezik për banorët ose kalimtarët e rastit, për arsye se kulmi i objektit që një kohë të gjatë rrjedh brenda uji i shiut, sepse nuk ka pas kurrë asnjë renovim. Ne pra po bëjmë plan që me e rrënuar këtë objekt, dhe në vendin e tij me bërë

një shesh për qytetarë, dhe nën të një parkim nëntoksor për automjete. Ne si Komunë, por as banorët nuk janë të interesuar për me investuar në këtë objekt. Në këtë objekt ka banesa dhe lokale afariste, e të ciët të gjithë do të kompenzohen, dhe për këtë projekt janë ndarë nga Qeveria 3 milion euro. Rrënimi i këtij objekti dhe endërtimi i një sheshi këtu është në përputhje të plotë edhe me Planin Zhvillimor. Ne kemi pas diskutim me qytetarë respektivisht banorë të objektit, dhe asnjë prej tyre nuk ka qenë kundër. Por ka pas shumë prej tyre që na janë drejtuar neve me pyetje teknike që më shumë kishin të bënin me çështjen e kompenzimit. Prandaj unë ju ftoj që ti rekomandoni Kuvendit miratimin e vendimit për rrënimin e këtij objekti.

znj. Adelina Beqaj: Përshëndetje. E di që deri para pak vitesh 3 ose 4 ka pas banorë që kanë jetuar në këtë objekt, tani pyetja ime është a ka edhe sot që jetojnë aty apo jo? Dhe pyetja e dytë është a ka ndonjë plan për bizneset që operojnë ose çka do të bëhet me ta?

z. Përparim Ramusa: Informatat që i dha janë të pakta, sepse po diskutojmë për një projekt me një shumë mjaft të madhe. Unë po kërkoj që procesverbalet e diskutimit publik na i dërgoni. Neve po na intereson më shumë vlera e shpronësimit. Edhe unë mendoj se ky objekt duhet me u rrënuar, por vota ime do të jetë “Abstenim”.

z. Kadri Emini: Po kthehem pak mbrapa në kohë, sepse kam disa paqartësi dhe do kërkoj informata shtesë. E para unë jam që ky objekt të rrënohet. E dyta sa i përket shpronësimit e dime që vlerësimin e bënë Komisioni i posaqëm i Ministrisë së Financave. Kostoja e këtij projekti mund të jetë e madhe prandaj mire është që investimin e bënë Ministria. E dimë që ka pas diskutim publik, por disa prej pronarëve nuk kanë qenë present. Mandej sa e di unë ka edhe disa lëndë nëpër Gjykata, për këtë arsye na duhen edhe disa informata shtesë, prandaj edhe në këtë fazë jemi “Kundër”.

z. Përparim Ramusa: Kam edhe një çështje për ta diskutuar, unë mendoj se është mire me diskutuar edhe për objektin e firmës “Eliabi” që është këtu ngjitur me këtë objekt. Është mire që kur të bëhet një shesh le të bëhet i mirëfillt, sepse nuk shkon parku me pas aty afër një objekt afarist të madh sikurse është “Eliabi”.

z. Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ: Sa kam informacione unë, tani nuk ka familje që banojnë në këtë objekt. Vlerësimi ka me u bë konform Ligjit, dhe vlerës së pronës në Shtime. Banorët nuk kanë me u dëmtuar. Sa i përket dëgjimit publik ju mundeni me pas procesverbalin nuk ka asnjë problem. E thash pra se nuk ka pas asnjë kundërshtim. Sa i përket koston së projektit, kur do të bëhet vlerësimi i pronave do ta dime sakt çmimin e investimit. Sa i përket pronarëve të objektit unë e di që ka pronarë me fletën poseduese por ka edhe prej atyre që janë banorë faktik. Fillimisht ne i thrrasim ata që janë pronarë me fletën poseduese, e pastaj do ta shohim sepse e dime që kemi mjaft punë për të bërë për sa i përket qartësisht të atyre që duhet tu paguhet kompenzimi. Sa i përket “Eliabit” edhe “Topilla Komerc”, ne planifikojmë që me diskutuar edhe me ta, por ne e kemi një barrierë fillestare tonën që duhet ta largojmë, dhe pastaj ta shohim. Në këtë projekt nuk duhet me pas mëdyshje askush.

z. Përparim Ramusa: Mëdyshja është se nëse nuk inkorporohet edhe hapësira e “Eliabit” projekti është gjysmak, sepse nëse rrënohet objekti para komune dhe objekti i tanishëm i Komunës atëherë mbetet në mes objekti afarist “Eliabi” që realisht nuk shkon fare me ambientin e parkut. Kështu që kjo pra neve na bën me pas dilema.

znj. Zejnije Veliu: Përshëndetje. E falënderoj drejtorin për informatat. Po bëhet fjalë për një projekt të madh dhe mjaft shumë të rëndësishëm. Drejtori e përmendi faktin që do të jenë në bisedime me bizneset si “Eliabin” dhe “Topilla Komerc”, pyetja ime në këtë rast është a do të mjaftojnë mjetet e ndara prej 3 milion edhe për shpronësimin edhe për ndërtimin e parkingut nëntoksor edhe për sheshin, dmth. për realizimin e projektit në tërësi.

z. Lumni Amrushi: Unë e lajmroj se nuk do të marr pjesë në votim, për arsye se unë kamë pronë në këtë objekt, dhe mendoj se kjo paraqet konflikt interesi, prandaj nuk do të votoj.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, me 3 vota “Për” me 1 votë “Kundër” dhe me 2 vota “Abstenim” vendosi t’i Rekomandon Kuvendit, MIRATIMIN e Vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm objektin afaristo-banesor përballë Komunës me komplet njësitë e sajë, si dhe me ngastrën kadastrale Nr.P-01667-1, Z.K-Shtime.**

Propozim-Vendim për anulimin e Vendimit Npi-01/346 dt. 31.10.2024 për themelimin e vendgjuetisë të përbashkët në teritorin e komunës së Shtimes

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha drejtorit Gojart Bajrami.

z.Gojart Bajrami, drejtor i DBPZHR: Përshëndetje. Ne e kemi një rekomandim të Ministrisë së Bujqësisë për rishqyrtimin e vendimit të Kuvendit Npi-01/346 dt. 31.10.2024 për themelimin e vendgjuetisë të përbashkët në teritorin e komunës së Shtimes, me arsyetimin se nuk është në përputhje me legjislacionin në fuqi. Meqenëse materialin e keni pranuar me kohë dhe besoj e keni lexuar kështu që unë nuk do ta lexoj prap këtu, mirëpo unë po kërkoj nga ju që ta anulojmë këtë vendim dhe procedurën pastaj ta fillojmë që nga fillimi, pak më vonë. Nëse ka dikush ndonjë pyetje unë do të përgjigjem.

znj.Adelina Beqaj: Me këto vendime që po na kthehen nga Ministria, ne si Kuvend po dalim jo serioz. Ti drejtor a nuk i ke pa këto gjëra të paligjshme apo si është puna?

z.Gojart Bajrami, drejtor i DBPZHR: Faleminderit për pytjen. Gjatë hartimit të propozim-vendimit ne i kemi pas përpara edhe Ligjin për Gjueti edhe Udhëzimin Administrativ, dhe sipas tyre i kemi ndërmarrë hapat. Në bazë të nenit 19.2 të Ligjit Nr.02/L-53 për Gjuetinë, i cili thot: *“Vendgjuetitë e përbashkëta i themelon Kuvendi Komunal në territorin e së cilës shtrihet sipërfaqja e tokës në të cilën themelohet vendgjuetia, me propozimin e organit komunal kompetent për punët e bujqësisë dhe pëlqimin paraprak të ministrisë”*. Ne e kemi qitë në Kuvend dhe është miratuar dmth. deri në Kuvend ne jemi në rregull, mirëpo gjërat ndryshojnë te pëlqimi i Ministrisë që e kemi marrë ne.

z.Përparim Ramusa: Para disa muajve na keni thenë me votu, dhe ju kemi dëgjuar dhe e kemi votu, tani po na thonë me anulu, unë vërtet te ky propozim jamë pak konfuz dhe do të “abstenoj” kësaj here.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, me 4 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 3 vota “Abstenim” vendosi t’i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Vendimit për ANULIMIN e Vendimit të Kuvendit Npi-01/346 dt. 31.10.2024 për themelimin e vendgjuetisë të përbashkët në teritorin e komunës së Shtimes.**

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Meqenëse diskutime tjera nuk ka, Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora 11:20h.

Procesmbajtësi
Idajet Rexhepi




Kryesuesi i KPF
Adnan Ademi

